

# **RILINDJA E RELIGJIONEVE**

Hazret Mirza Tahir Ahmad

**Title**

Rilindja e Religioneve  
*Albanian Translation*  
Revival of Religion

**Author**

Hadhrat Mirza Tahir Ahmad  
Head of the world-wide Ahmadiyya Muslim Jamaat

**Translator**

Muhammad Zakaria Khan

**Published by :**

Islam International Publications Limited  
"Islamabad"  
Sheephatch Lane  
Tilford, Surrey GU 10 2AQ  
United Kingdom

© *Islam International Publications Limited*

1 <sup>st</sup> Edition	1988
2 <sup>nd</sup> Edition	1994
3 <sup>rd</sup> Edition	1995
Present edition	April 2000      15.000

ISBN : 1 85372 123 9

Printed by:  
Interprint Limited, Malta

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ  
تَحْمِدُهُ وَتُصَلِّيُ عَلَى رَسُولِهِ الْكَرِيمِ

## Rilindja e Religjioneve

Sot dëshiroj të flas me ju rreth filozofisë islamiqe të rilindjes së religjioneve. Religjionet gjithmonë rilinden me intervenimin direkt të Allahut xh.sh. Ai e dërgon ndonjë reformator i cili angazhohet t'i kthejë njerëzit nga materializmi në drejtësim të Krijuesit të tyre të vërtetë. Reformatorët e këtillë vazhdimisht i ftojnë njerëzit në drejtësim të sakrificave të mëdha që bëhen në emër të Zotit, dhe i thërrasin ata që të bëjnë përpjekje dhe orvatje të mëdha në rrugën e Zotit. Ndjekësit e tyre në këtë rrugë tregojnë qëndrim të paluhatshëm dhe dalin të palëkundshëm. Po kështu, ata reformatorë i informojnë njerëzit, të cilët dëshirojnë të jetojnë, që ata patjetër të pranojnë një vdekje për vete. Nga ana tjetër, reformatori i stërvit dhe i përgatit ata të bëjnë përpjekje të gjata e të mundimshme kundër kundërshtimit dhe të persekutimit të verbër që shfaqet nga dora e atyre personave, ndaj të cilëve këta mbajnë një simpati dhe dashuri dhe mundohen e përpiken t'i shpëtojnë ata nga shkatërrimi i tyre. Me të vërtetë, kjo është filozofia reale dhe e amshueshme e rilindjes religioze. Çdo filozofi tjetër që bie ndesh me këtë, është vetëm fantazi. Lidhur me këtë, unë duhet patjetër të përmend se të gjitha sektet e Islamit lidhur me këtë temë nuk janë të njëmendtë. Një numër i madh i myslimanëve beson se është bërë një ndryshim fundamental në formë të rilindjes religioze. Shumë myslimanë pajtohen me këtë pikëpamje themelore. Mirëpo, krahas kësaj, Xhemati Islamik

Ahmadia beson se ky proces historik është i rrjedhshëm, i vazhdueshëm dhe i pandryshueshëm. Pra, mos të ndodhtë që për shkak të diferencimit të opinionit në mes të myslimanëve, të krijohet ndonjë përshtypje e gabueshme, më duket e nevojshme t'i përmend ato besime dhe dogma fundamentale që i lidhin të gjithë myslimanët në një rrëth, pa marr parasysh se cilit sekt i takojnë ata.

Pra, çdo mysliman, pa marr parasysh se cilit sekt i takon ai, beson në Tohidin (unikatësinë) e Zotit dhe në profetizmin e Profetit të shenjtë Hazret Muhammedit s.a.s. Secili mysliman beson se Islami është religjon i fundit për shpëtimin e tërë njerëzimit. Të gjithë myslimanët besojnë se me anë të këtij religioni të gjitha nevojat shpirtërore të njeriut plotësohen dhe do të plotësohen deri në Ditën e Gjykimit. Të gjithë myslimanët besojnë se Sheriati i Islamit është i pandryshueshëm, i pavdekshëm dhe i pa zëvendsueshëm, dhe se asnjë pikë a shenjë e tij nuk mund të pësojë ndonjë ndryshim. Myslimanët e të gjitha shkollave të mendimit besojnë se urdhërat e Profetit Hazret Muhammed s.a.s. janë të vlefshme dhe do të janë të atilla e të autorizuara deri në diten e fundit të njerëzimit. Myslimanët e të gjitha sekteve besojnë se dritën e vërtetësisë së amshueshme mund ta përfitojë vetëm ai i cili sinqerisht dhe besnikërisht e ndjek dhe do ta ndjekë rrugën e Hazret Muhamedit s.a.s. Këto janë ato pika ku të gjithë myslimanët, pa përjashtim, bashkohen e pajtohen.

Megjithë këto pajtime të përgjithshme, ekziston një diferencë fundamentale që e ndan Xhematin Ahmadija prej të gjitha sekteve të tjera të Islamit. Ajo është diferenca që ka të bëjë me temën e rilindjes së Islamit. Të gjitha diferençat e tjera burojnë nga kjo temë kryesore.

Si do të ringjallet e do të lulëzohet feja Islame? Si do të këtë ajo një jetë të re dhe si do të fitojë vitalitetin e vet? Të gjithë myslimanët, po edhe ahmadianët, besojnë se përgjigja e këtyre pyetjeve është e lidhur ngushtë me ardhjen e Masihut të Premtuar-biri i Merjemës, dhe me ardhjen e Imam Mahdiut të

Premtuar, të cilin Zoti do ta dërgojë. Kjo është ajo pikë e përbashkët rreth së cilës të gjithë myslimanët pajtohen. Por, kur kjo pikë interpretohet, krijohen në të vërtetë dy pikëpamje diametrikisht të kundërta.

Sipas Xhematit Ahmedia, paralajmërimi i ardhjes së Masihut është një ligjërim metaforik dhe paralajmerimet lidhur me Imam Mahdiun janë në formë simbolike. Ne ahmadianë besojmë se paralajmërimet e tilla i mbajnë në vete shumë kuptime që nuk mund të kuphoon, poqëse merret në konsiderim vetëm forma e tyre letrare. Mirëpo, përkundër kësaj, sektet e Islamit insistojnë se këto paralajmërime do të plotësohen letrarisht dhe këto nuk kanë kuptime metaforike. Kjo është ajo diferençë fundamentale që e dallon dhe e ndan Xhematin Ahmedia prej të gjitha sekteve të tjera të Islamit.

## PRAPASKENA E PROFECIVE

Degradimi e rënia ekzistuese e myslimanëve të sotëm nuk është ndonjë ngjarje e rastësishme për të cilën Profeti i Shenjtë Hazret Muhammedi s.a.s. nuk ishte informuar. Pra, Profeti i Islamit duke marrë diktimin Hyjnor praj Zotit, pat paralajmëruar, para 1400 vitesh, se feja Islame dikur do të ndahet në 72 sekte. Ai, me të vertetë, tregoi rreth situatës së tanishme të myslimanëve sikurse ai i kishte parë me sytë e vet të gjitha ngjarjet dhe ndodhitë e epokës sonë. Pa dyshim, të thënët e Profetit Muhamedit s.a.s. e përfshijnë përshkrimin grafik të kohës sonë. Siç ai tha:

*“Asgjë nuk do t’i mbetet Islamit, përveç emrit të tij; asgjë nuk do t’i mbetet Kur'anit, përveç shkronjave të tij; xhamitë megjithëse do të jenë të mbushura me njerëz, do të jenë të zbrazëta nga hidajeti dhe hoxhallarët e atyre njerëzve do të jenë krijesë më sherrxhi nën kupën e qiellit”. (Mesned Ahmad: Kenzul Aamat; Vol. 7,f.203)*

Megjithë këto paralajmërimë të tmerrshme, ai dha edhe lajme të përgëzueshme. Pra, kur ai në një anë dha paralajmërimë rreth dobësimit dhe të venitjes së Islamit, aty në anën tjetër paralajmëroi me fjalë të hapura se feja Islame nuk do të shkatërrohet tërësisht siç ai tha:

كَيْفَ تَهْلِكُ أُمَّةً إِذَا أَوْلَاهَا رَعِيسٌ أَبْنُ مَرْيَمَ آخِرُهَا

*“Si mund të shkatërrohet ai ymet, në krye të të cilët gjendem unë, ndërsa Masihu - biri i Merjemës do të jetë në fund”. (Mesnad Ahmad: Kenzul Aamal vol.7, f.203)*

Mandej tha:

كَيْفَ أَتَقُمُ إِذَا نَزَلَ أَبْنُ مَرْيَمَ فِيْكُمْ وَإِمَامُكُمْ مِنْكُمْ

*“Si do të ndiejni veten, kur në mesin tuaj do të zbresë Biri i Merjemës dhe ai do të jetë Imami juaj nga mesi juaj”.*

*(Bukhari)*

Ai vazhdoi duke thënë:

وَالَّذِي نَصَّبَ لَيْلَةً لَيْلَةً كَيْمَانًا لَيْلَةً فِيْكُمْ

أَبْنُ مَرْيَمَ حَكَمًا عَدْلًا

*“Pasha atë Zot, në dorën e të cilët ështëjeta ime, Biri i Merjemës patjetër do të zbresë në mesin tuaj dhe ai do të jetë arbitër e gjykues me drejtësi”.* (Bukhari)

Profeti i shenjtë gjithashtu ka dhënë lajme të përgëzueshme rreth një Imami të madh-Imam Mahdiu i cili do të vijë bashkë me të birin e Merjemës. Pra, Xhemati Ahmedia beson ashtu siç besojnë të gjitha sektet e tjera se rilindja e Islamit dhe triumfi i tij global është i lidhur ngushtë me ardhjen e Masihut dhe të Imam Mahdiut. Mirëpo, Xhemati Ahmedia dallohet dhe veçohet prej të gjitha sekteve të tjera për shkak të interpretimit të këtyre paralajmërimeve, sepse Xhemati Ahmedia

insiston që këto profeci duhet të analizohen nën dritën e ligjeve hyjnore dhe sipas historisë së profetëve të mëparshëm. Ndërsa, sektet e tjera të Islamit besojnë se këto profeci nuk e mbajnë në vete ndonjë mesazh të brendshëm dhe të thellë, por përdoren e të mirren letrarisht.

## KONCEPTI 1 MYSLIMANËVE JO-AHMADIAN

Duke dalë i drejtë ndaj opozitarëve tanë, unë tani do të sqaroj më gjérësisht pikëpamjen e opozitarëve tanë, të cilët besojnë se me renesancën e Islamit duhet kuptuar dominimi e tij politiko-ekonomik. Aty ka nevojë pëe një sqarim. Dëshira e ethshme për fuqinë dhe laktmia për pasurinë tradionalisht ka dominuar në grindje njerëzore. Kulmi i rigjallërimit nacional do të thotë epërsia e tij politiko-ekonomike.

Favori Hyjnor, sipas tyre, duhet të sjellë rezultate të tilla. Kjo është pikëpamja pak a shumë të gjithëve rrëth rilindjes së Islamit. Sipas këtij besimi, ardhja e Masihut do t'ia japë Islamit triumfin politik, kurse ardhja e Imam Mahdiut do t'ia japë dominimin ekonomik.

Këtu, së pari, e përmend konceptin e myslimanëve lidhur me ardhjen e Masihut. Myslimanët besojnë se Masihu-Biri i Merjemës, të cilin Kur'an e deklaron si profet të Izraelit, do të zgresë prej qiellit me trupin e tij fizik. Ai, fill pas zbritjes, do ta kapë shpatën në dorë dhe do t'i vrasë të gjithë armiqtë e Islamit. Në këtë betejë globale ai do të ketë tri qëllime kryesore dhe të madhërishme:

1. Qëllimi i parë i tij do të jetë se ai do ta shkatërrojë Kryqin, jo figurativisht por letrarisht. Ai do të vendosë të thejë simbolin e krishterizmit në mënyrë aq vullgare sa që nuk do të mbetet ndonjë shenjë e këtij simboli. Nuk do të mbetet asnjë Kryq që do të mund të shihej nëpër kisha, nëpër shtëpi e në qafore.
2. Qëllimi i tij i dytë dhe i rëndësishëm, sipas tyre, është se ai do të mbysë të gjitha llojet e derrave - shtëpiakë dhe ato të egra.

Kështu, ndjekësit e krishterizmit do të mbeten pa kryq që ta adhurojnë dhe pa derra që të ushqehen. Kjo do të thotë se ai nuk do të lejojë që të krishterit të kenë ndojnë artikull të ushqimit shpirtëror e as të ushqimit fizik.

3. Qëllimi i tretë i Masihut do të jetë se ai do ta vrasë Dexh'xhalin-Anti-Krishtin. Këtu shtrohet pyetja se kush është Dexhxhali? Sipas të thënave të profetit Muhamed s.a.s. ai është kolos me një sy që do të vijë i hypur mbi një gomar të një mase të jashtëzakonshme. Ai gomar do të jetë aq i gjatë sa që koka e tij do të dalë përtej reve. Të gjithë profetët ia kanë tërhequr vërejtjen kombit të tyre nga sherri i këtij Dexhxhali. Mirëpo, në anën tjetër, ekziston paralajmërimi se kur Dexhxhali do të jetë i angazhuar nëpër tokë në veprimitari shkërruese e do të dominojë në botë, atëherë Masihu i Premtuar do të zgresë prej qiellit. Ai do të luftojë kundër Dexhxhalit afér Damaskut dhe do ta mposhtë atë. Mandej, Masihu i Premtuar, sipas opozitarëve tanë, do ta mposhtë dhe do ta pushtojë tërë botën. Pasiqë do të ketë kryer këtë punë, ai myslimanëve do t'u dorëzojë frenin qeverisë së botëse.

Pra, kjo është ajo filozofi e triumfit dhe e rigjallërimit politik të myslimanëve që tërësisht i shkarkoi dhe i çlroi myslimanët të bëjnë ndonjë përpjekje politike etj. Tani, ata të cilët janë të dehur në këtë vetëmashtrim se pa bërë ndonjë orvatje dhe pa derdhur djersë do ta trashëgojnë tokën, nuk mund të arsytohen se janë njerëz të politikës dhe të praktikës. Ata jetojnë pa ndërgjegje ndaj rënimit dhe degradimit të tyre. Përveç kësaj, ata janë shumë të sigurtë se çastet e lumturisë nuk janë larg, kur një qenie Hyjnore do të zgresë prej qiellit dhe do ta zgjidhë fushatën e pushtetit. Ai do ta mbysë derrin, do ta thejë Kryqin dhe do të marrë në dorë të gjitha fuqitë e Lindjes dhe të Perëndimit. Atëherë, një ditë ai do t'i thërrasë myslimanët, të cilët do ta pritnin këtë ditë, dhe do t'u thotë:

*"Ejani këtu O ju ushtarë të Zotit, ejani këtu o ju besimtarë!"*

***Ejani dhe merreni këtë skeptër të mbretërisë së tokës"***

Kjo ëshë pikëpamja luftëdashëse e renesancës së myslimanëve, të cilën Xhemati Ahmadija e urren dhe e refuzon. Ata nuk mund ta përshkruajmë këtë në mënyrë vulgare të fjalë përfjalshme.

Koncepti tjetër i myslimanëve jo-ahmadianë është ai i triumfit ekonomik të fesë Islame. Dijetarët e hoxhallarët e sekteve të tjera e mbajnë dhe e paraqesin një pikëpamje të çuditshme rreth ekonomisë islamike. Sipas tyre, problemi ekonomik i myslimanëve nuk do të zgjidhet me anë të përpjekjeve e të mundimeve të pa ndërprera, por, përkundrazi, ky problem ekonomik do të zgjidhet vetëm me ardhjen e Imam Mahdiut, i cili do të jetë bashkëkohësi i Masihut. Akti i tij më i rëndësishëm, me të ardhur në botë, do të jetë se ai do t'ua falë myslimanëve të botës pasuri të pakufishme. Kjo pasuri do të jetë dhuratë e pakufishme, dhe zemërgjerësia e tij do të jetë e papërshkrueshme. Me anë të kësaj pasurie, do të tejkalohet kapaciteti i nevojave të myslimanëve dhe ata nuk do të kenë nevojë ta tubojnë atë. Atëherë, do të marrë fund dëshira e ethshme përfshirë të mirat dhe lakinia përfshirë. Ky është, siç mendojnë disa, i vetmi ilaç i sëmundjeve ekonomike të botës Islame. Sipas këtij besimi, ardhja e Imam Mahdiut në vete është përgjigja e mjerimit ekonomik të myslimanëve. Nuk ka nevojë që të bëhen përpjekje, të derdhen lotë dhe të derdhet djersë. Nuk ka nevojë të eksplorohet toka që të nxirren pasuritë e saj, të përgjohet në zemrën e atomit dhe s'ka nevojë të zbulohen sekretet dhe fshehtësitë e hapsirës. Nuk ka nevojë as përfshirë e as përfshirë industri dhe as të bëhen zbulime të "reja, sepse myslimanëve u nevojitet vetëm ardhja e Imam Mahdiut. Mirëpo, ne ahmadianë, e hedhim poshtë këtë koncept dhe e konsiderojmë si fëmijënor, vullgar dhe të papranueshëm.

## INTERPRETIMI KORREKT SIPAS MYSLIMANËVE AHMADIANË

Megjithëse Xhemati Ahmedia në asnjë mënyrë nuk i hedh poshtë paralajmërimet rreth zbritjes së Masihut dhe të ardhjes së Imam Mahdiut, por sipas tij është naiviteti i shkallës së lartë dhe injoranca e madhe që këto paralajmërime të mirren letrarisht. Ne besojmë se interpretime të tillë burojnë për shkak se njerëzit nuk e kanë kuptuar pozitën e lartë të profetit Hazret Muhammed s.a.s., andaj janë bërë aq shumë gabime serioze për të kuptuar mirë mesazhin e tij të thellë filozofik.

Nuk mohohet fakti se dijetarët, shkrimtarët dhe njerëzit e arsyeshëm zakonisht i paraqesin disa përmbajtje të rëndësishme në mënyrë parabolike dhe alegorike, por njeriu i përcipët dhe mendjelehtë nuk mund të kuptojë domethëniet e tyre. Një mysliman ahmadian beson se i tërë subjekti lidhur me Masihu, me Dexhxhalin dhe me gomarin e tij është alegori. Prandaj, Masihi nuk do të jetë ai profet që erdhi dikur në mesin e izrailianëve. Ahmadianët besojnë se Krishti (Masihi) ka vdekur me vdekjen e tij të natyrshme pasiqë i përballoi torturat e Kryqëzimit. Pra, Masihi i Premtuar dhe i paralajmëruar në të vërtetë do të jetë ai person i ri që do të lindë nga mesi i ihtarëve të Profetit të Shenjtë Muhammedit s.a.s. Mirëpo, për shkak të ngjajshmiërisë në disa karakteristika me Krishtin, atij i jepet titulli i Masihut, birit të Merjemës, ashtu siç një dramaturg të madh e quajmë Shekspir. Kështu është edhe puna me Kryqin. Masihi nuk do t'i thejë letrarisht kryqet, por, përkundrazi, ai fesë të krishtere do t'i japë disfat me anë të argumenteve dhe të rezoneve të fuqishme. Pra, thyerja e kryqit do të thotë disfata ideologjike e botës krishtere.

Poashtu, edhe fjala "derr" nuk duhet marrë në formën e saj letrare, por kjo tregon kulturën e fëlliqtë e të ndytë të Perëndimit që e bën njeriun si derr. Fjala derr përdoret për anarkinë seksuale

që dominon në Evrope dhe në Amerikë. Kjo tregon shthurjen dhe zvetënimin e pakëndshëm ku edhe fëmijët e papjekur bëhen viktima të kësaj katastrofe.

Të thënët e Profetit Muhammedit s.a.s. nuk tregojnë dhe nuk flasin në mënyrë të prerë se Masihi do të shkojë në gjueti që t'i mbysë derrat e egra dhe ato shtëpiake. Po të ndodhet kështu atëherë, pa dyshim, kjo do të paraqitej një imazh dhe portret të çuditshëm të Profetit të Zotit. Një besim i tillë e freskon kujtimin e Ajaksit-heroin e mitologjisë greke, i cili duke u çmendur e preu kopenë e lopave dhe të deleve duke i konsideruar prijësit e ushtrisë greke.

Kështu, edhe Daxhxhali është përdorur në formë simbolike, siç u përdorën fjalët Masihi, Kryqi dhe Derri. Pra, Dexhxhali e simbolizon kombin e fuqishëm dhe të madh që dominon jo vetëm në tokë por edhe në hapsirë (gjithësi). Kryqi dhe derri janë simbole të atij kombi. Të thënët e Hazret Muhammedit s.a.s. tregojnë se syri i djathtë i Dexhxhallit do të jetë qorr, ndërsa syri i tij i majtë do të jetë shumë i shndëritshëm. Ky është shpjegim simbolik i faktit se kombi i tij do të jetë qorr nga drita shpirtërore, kurse drita e tij materiale dhe arritje materiale do të jenë të mëdha.

Në fund, myslimanët ahmedianë, gomarin e Dexhxhalit e konsiderojnë si simbol – një simbol që është përdorur për të treguar mjetet e transportit në ditët e ardhshme. Të gjitha tiparet e pëmendura rrëth këtij gomari, papërashtim, identifikohen me anë të mjeteve transportuese të fuqishme dhe të prodhuara në Perëndim. Siç janë të përmendura në Hadith tiparet e gomarit të Dexhxhalit se ai do të ushqehet me zjarr; do të udhëtojë nëpër tokë, nëpër det dhe nëpër ajer; shpejtësia e tij do të jetë aq e madhe sa që udhëtimi i muajve do të kryhet për disa orë; pasagjerët nuk do të udhëtojnë mbi shpinën e tij, por në barkun e tij; ai para nisjes do të lajmërojë dhe do t'i ftojë udhëtarët që të ulen. Plotësimi i të gjitha këtyre tipareve në mënyrë të çuditshme, në një anë është argument i prerë dhe mjaft solid i

vërtetesisë së Profetit Muhammed s.a.s. dhe, në anën tjetër, e verifikon pikëpamjen dhe besimin e ahmadinëve.

Sipas myslimanëve të Xhematit Ahmadija edhe paralajmërimet rrëth ardhjes së Imam Mahdiut janë në formë simbolike. Pasuria që Imam Mahdiu do të shpërndajë në mesin e myslimanëve, do të jetë pasuria e diturisë dhe e zgjuarësisë shpirtërore e jo pasuria e botës materiale. Sepse, refuzimi i pranimit të një pasurie të tillë dëshmon qart se çfarë lloji pasuri është kjo. Njeriu kurrë nuk ngopet me pasurinë materiale, ndërsa pasurinë shpirtërore njeriu nuk dëshiron ta pranojë.

Pra, Xhemati Ahmadija e hedh poshtë filozofinë e paraqitur prej sekteve të tjera të Islamit rrëth renecansës së Islamit. Ai edhe beson se një filozofi e tillë është tërësisht kundër qëllimit të Kur'anit, kundër historisë së profetëtve dhe më së shumti kundër veprave të Profetit Muhammed s.a.s. Xhemati Ahmedia shmanget e largohet prej këtij opumi ideologjik që e shtynë popullin në gjumin e papunësisë dhe e shtynë atë në botën e vetëmashtrimit e të fantazisë.

## FILOZOFIA AHMADIANE RRETH RENESANCËS RELIGJIOZE

Kjo filozofi nuk dallohet prej asaj që është trashëgim i përbashkët i të gjitha religjioneve. Kjo është e vetmja ajo filozofi, të cilën e përkrah edhe historia. Megjithëse, Skriptet dhe legjendat i përmenden shumë persona të tjere, për të cilët flitet se kanë shkuar në qzell dhe se do të kthehen apo do të zbresin një ditë. Mirëpo, prej Ademit e gjerë më sot nuk ka ndonjë shembull që dikush është kthyer me trupin e tij fizik e as që zbriti fizikisht në tokë. Pra, paverësisht nga diferencat në mënyrën e të paralajmëruarit rrëth ngritjes së dikujt në qzell, nuk ka asnë person i cili ka raportuar se pas një mungese të gjatë është kthyer në tokë. Reformatorët përherë janë paraqitur në tokë si të lindur nga barku i nënave dhe gjithnjë janë refuzuar,

janë përqeshur dhe janë përbuzur prej njerëzve. Për ta kurrë nuk janë organizuar ceremoni të pritjes. Nuk iu dhuruan kurorë lulesh. Nuk janë ndezur prej gjëzimit llamba ndriçuese. Përkundër kësaj, ata që erdhën në emër të Zotit, u përsekutuan përshkak të këtij "krimi". Krugët e tyre u mbushën me gjemba. U hodh pluhuri mbi kokat e tyre dhe u gjuajtën me gurë. Ata u kurorëzuan me kurorë gjembash. Çdo torturë e mundshme dhe e përfytyrueshme është bërë kundër tyre. Një pikture e kësaj shihet qartë në jetën e es-habëve të Hazret Muhammedit s.a.s. Ju i shikoni ata duke u kthyer prej fshatit Taif të zhytir në gjak prej kokës e gjerë më këmbë. Prapë i shikoni ata në fushëbetëjë të Ohadit, gjysmë të vdekur për shkak të plagave, dhe të varrosur nën trupat e atyre, të cilët ua kanë falur jetën e tyre.

Ju mund t'i gjeni ndjekësit e të gjithë profetëve të ballafquar me të njëjtën fat. Çdo torturim i përfytyrueshëm është praktikuar kundër tyre. Ata janë tërhequr zvarr nëpër rrugë të palëmuara e të gurta. Janë detyruar të shtrihen mbi rërën përvëluese e lëkurëdjegëse nën rrezet e diellit përvëlues. Ata janë hedhur gjoksazi mbi prusha dhe nuk janë lejuar që të çoheshin deri sa nuk janë shuar prushat.

Ata janë dëbuar prej shtëpive dhe prej atdheut të tyre. Ata janë kërcënuar me uri. Janë copëtar me shpata. Mosbesimtarët i ndanin ata prej bashkëshorteve të tyre dhe bashkëshortet i ndanin prej burrave të tyre. Prindërit janë privuar nga fëmijët e tyre. Atyre u refuzohej çdo e drejtë e jetës. Ata nuk patën të drejtë të faleshin e as të ndërtonin ndonjë xhami. Dhe jo vetëm kaq, por ata as nuk patën të drejtë që ta proklamonin fenë e tyre e as ta pagëzonin fisin e tyre me ndonjë emër.

Kjo është ajo jetë e re shpirtërore që i jepet njeriut. Kjo është ajo rrugë që çon deri te rilindja e religionit. Ky është ai fenomen, të cilin e shohim në jetën e Profetit Muhammed s.a.s. dhe në jetën e profetëve të mëparshëm. Ashtu profetët duke e udhëdhequr kombin e vet nëpër rrugët e vështira e të përvuajtshme, i ringjallin kombet e tyre. Kjo është, me të vërtetë, filozofia e rilindjes së religjioneve që ekziston prej

Ademit e deri në ditët e Profetit Muhammed. s.a.s. Pra, duke e parë një realitet të prerë që përherë është manifestuar në një formë të vetme, atëherë si mund të besojmë që Zoti i Plotëfuqishëm ka vendosur ta ndërprejë këtë praktikë të pacenueshme dhe të rrjedhshme? Si mund të besojmë, pra, e të pranojmë se myslimanët pa derdhur një pikë gjaku e pa bërë ndonjë përpjekje e sakrificë do të bëhen mbretër të tërë botës? Si mund të besojmë se myslimanët do të korrin sukses pa ecur rrugëve të sakrificave e të përpjekjeve? Kurrë s'ka ndodhur kështu e as që do të ndodhë në të ardhmën. Masihu i Premtuar, themeluesi i shenjë i Xhematit Ahmedia në Islam, e paraqiti një realitet të amshueshëm që nuk mund të hidhet poshtë e në anën tjetër ai e alarmon kombin me këto fjalë:

*"Nuk ka kaluar asnijë profet që nuk u përqesh. Pra, është e domosdoshme që njerëzit ta përqeshin edhe Masihun e Premtuar."*

Zoti thotë:

يَحْسُنَةٌ عَلَى الْعِبَادِ مَا يَأْتِيهِمْ مِّنْ رَّسُولٍ  
إِلَّا كَانُوا يَهْوَى بِهِ يَسْتَهِزُءُونَ -

*"Vaj për robët e mi të cilët, kur erdhi tek ata ndonjë profet, e përqeshën.* (36:31)

Masihu i Premtuar prapë thotë:

*"Pra, kjo është një shenjë prej Zotit se çdo profet është përqeshur dhe përbuzur. Tani, tregoni se kuš do ta përqeshë atë që, duke u shoqëruar me engjupt, do të zgresë fizikisht prej qiellit në mesin e turmës njerëzore që e pret atë? Prandaj, njeriu intelektual mund të besojë se zbritja fizike e Masihut të Premtuar prej qiellit është besim i rrejshëm dhe i pabazë. Mbani mend se askush nuk do të zgresë prej qiellit. Ata të gjithë që më kundërshtojnë mua dhe tani janë të gjallë, do të vdesin por askush prej tyre nuk do ta shohë Masihun-birin e Merjemës, duke zbritur*

*prej qiellit. Jo vetëm kaq, por edhe fëmijët e tyre e bile edhe fëmijët e fëmijëve të tyre do të vdesin, por nuk do ta shohin duke zbritur Birin e Merjemës. Atëherë Zoti i mbush zemrat e tyre me frikë se ditët e kulminacionit të Kryqit kanë kaluar dhe Masihu-Biri i Merjemës ende nuk është zbritur prej qiellit. Atëherë, i mençuri do të lodhet e do të mërzitet nga ky besim. S'do të kalojnë tre shekuj prej sotit që myslimanët dhe të krishterët do ta hedhin poshtë me hidhërim dhe me dëshpërim e meurrejtje ketë besim të rrejshëm. Atëherë në botë do të mbetet vetm një religion dhe vetëm një udhërrëfyes (Islami dhe Hazret Muhammedi s.a.s.-përkthyes). Unë kam ardhur të mbjellë vetëm farën dhe kjo farë është mbjellë nga dora ime. Tani kjo do të rritet e do të lulëzohet. Ajo do të jepë fryte dhe nuk ka fuqi në tokë që mund ta dëmtojë e ta çrrënjosojë këtë farë."*

*(Tazkiratosh-Shahadeten,f.64-5)*

Faktikisht, çdo njeri i dishëm dhe i arsyeshëm nga ky krahasim mund të nxjerrë konkludimin se pikëpamja e Xhematit Ahmadia bazohet mbi historinë e feve, ndërsa filozofia e opozitarëve të tij është vetëm mit e fikcion dhe bie ndesh me historinë e rilindjes së feve. Historia na mëson se secili që është zgjedhur dhe është dërguar prej Zotit, është ballafaquar me stuhinë e kundërshtimit. Të gjithë profetët kanë ardhur duke e bartur mesazhin e vërtetësisë dhe të jetës së amshueshme, por përherë ata u kundërshtuan prej atyre personave të cilët e përqafuan gënjeshtren në vend të vërtetës dhe vdekjen shpirtërore në vend të jetës shpirtërore. Ky është, pa dyshim, procesi i lindjes së religjioneve dhe kur korrupcioni dhe ndytësia shpirtërore depërtojnë në fe, atëherë rilindja e tyre merr të njëjtën rrugë. Poashtu, edhe reformatorët e dërguar prej Zotit janë trazuarur dhe janë shqetëuar, siç janë trazuar të gjithë profetët e Zotit. Mirëpo, kurdoherë Allahu xh.sh. vendos ta ringjallë shpirtërisht ndonjë komb, ai ndahet në dy grupe: grupi i parë i përfshin ata që e njohin dhe e pranojnë të vërtetën, ndërsa

grupi i dytë i përfshin ata që e refuzojnë dhe e kundërshtojë atë vërtetësi. Por, as grupi i parë e as i dyti nuk i ndërron sjelljet e veta. Kur'ani e përmend shpesh këtë cikël përsërítës në mënyrë shumë efektive e interesante. Një vështrim i Kur'anit tregon:

1. Religjonet linden dhe ringjallen me anë të reformatorëve të dërguar prej Zotit. Asnjë herë s'ka ndodhur që hoxhallarët e dijetarët e ringjallën dhe e riformuan ndonjë fe me anë të konferencave e të konsultimeve të tyre.
2. Reformatorët e ardhur prej Zotit përherë janë refuzuar prej popullit të vet dhe janë sjellë me arrogancë dhe me urrejtje.
3. Reformatorët e tillë gjithëmonë janë pritur me brutalitet. Ata janë akuzuar se gjoja e shkatërrojnë religionin e stërgjyshëve të tyre, se i njollosin dogmat e tyre dhe janë kërcënuar me dënim për ndërrimin e fesë.
4. Mosbesimtarët besojnë se këta reformatorë duhet të dëbohen ose të dënohen me vdekje. Kështu reformatorëve u jipet rast që të braktisin vendin apo të kthehen prapë në religionin e tyre të mëparshëm apo të pranojnë dënim me vdekje.
5. Reformatorët kurrë nuk e ndjekin rrugën e mizorisë dhe të brutalitetit. Ndjekësit e tyre gjithnjë shfaqin në rrugën e tyre një qëndrim aq të lartë sa që nuk frikësohen e as nuk shqetësohen për shkak të kërcënimeve të kundërshtarëve për dëbim dhe për dënim me vdekje. Ata kurrë nuk pendohen për atë besim, të cilin e përqafojnë.
6. Reformatorët e tillë kurrë nuk e tubojnë popullin rreth vetes duke i premtuar se do t'ua japid pushtetin dhe mbretërinë. Përkundrazi, ata e largojnë popullin nga nocioni i botës materiale dhe nuk e grumbullojnë duke u dhënë lakmi për pasuri. Nga ana tjetër, ata japid mësim e predikim rreth shpirtit të sakrificës. Të pasurit që u besojnë reformatorëve i falin të gjitha pasuritë e tyre në rrugën e Zotit dhe nuk mërziten fare për nder e për respekt të botës. Atëherë,

providenca e Zotit i bën të aftë ta marrin frenin e pushtetit në dorë.

Ky është procesi i rilindjes së religjioneve e të kombeve që i përmend Kur'ani dhe Skriptet e shenjta. Të gjithë profetët prej Ademit e gjerë te Profeti i shenjtë Hazret Muhammedi s.a.s. kanë kaluar nëpër të gjitha këto situata. Ata ia dhanë kombit të vet një jetë të re duke e udhëdhequr në rrugën e vuajtjeve e të sakrificave. Ata dhanë mësim dashurie. E mësuan popullin dhe e edukuan të bëjë përpjekje dhe akcione të pandërprera. Pa dyshim, ky është shpirti revolucionar që ua jep jetën kombeve të vdekura. Ky ligj Hyjnor që u demonstrua përherë në mënyrë të pandryshueshme, është në pajtim të plotë me natyrën, ndërgjegjen dhe me intelektin e njeriut. Prandaj, Xhemati Ahmedia e pranon këtë formë të paraqitur më lart.

Pra, siç shihet, koncepti i rilindjes së feve, të cilin e paraqet Xhemati Ahmedia, nuk është ndonjë filozofi e lindur prej imagjinatës së njeriut, por ky koncept buron nga procesi i vazhdueshëm dhe i pandryshueshëm historik që më së miri e më realisht është ruajtur në Kur'an. Një koncept i tillë është bazuar mbi principet e amshueshme e mbi vërtetësinë që është bazë e çdo religioni të vërtetë.

P.sh. Kur'ani thotë:

لَا إِكْرَاهٌ فِي الدِّينِ قَدْ تَبَيَّنَ الرُّشْدُ مِنَ الْغَيْرِ فَمَنِ يَكْفُرُ  
بِإِلَٰهٖ أَغْرَىٰ بِهِ وَيُؤْمِنُ بِاللَّٰهِ فَقَدِ اسْتَمْسَكَ بِالْعُرْوَةِ الْوُثْقَىٰ لَا  
انْفَضَامَ لَهَا وَاللَّٰهُ سَوِيعُ عَلَيْهِ -

"Se nuk ka dhunë në fe. Rruga e drejtë, padyshim, është dalluar prej asaj së gabueshmes. Pra, ai që refuzon të ndjek atë rrugë që e degjeron dhe e devijon, dhe beson në Zot, me të vërtetë e kap fuqimisht dorëzën që nuk thehet. Zoti është i Gjithëdëgjueshëm dhe i Gjithëdijshëm.

(Al-Bakara: 257)

لَهُنَّ أَعْسَرَةٌ عَلَى الْعِبَادِ مَا يَأْتِيهِمْ مِنْ رَسُولٍ  
إِلَّا كَانُوا يَهُمْ يَسْتَهِزُونَ -

"Vaj për robët e mi të cilët, kur erdhi ndonjë profet tek ata, e përqeshën.  
(Jasinë:31)

إِنَّ اللَّهَ لَا يُغَيِّرُ مَا بِقَوْمٍ حَتَّى يُغَيِّرُوا مَا بِأَنفُسِهِمْ -

Pa dyshim, Zoti nuk krijon ndonjë ndryshim në një popull, gjerësa ai popull vetë nuk krijon një ndryshim në vete.  
(Al- Rad:12)

Tani, sa për ilustrim, po i përmend disa ato vërejtje që morën profetët e Zotit në kohë të ndryshme nga populli i tyre. Hazret Shuejbi e morri vërejtjen prej kombit të vet me këto fjalë:

لَنُخْرِجَنَّكُمْ يَشْعَيْبُ وَالَّذِينَ آمَنُوا مَعَكُمْ مِنْ  
قَرْبَتَنَا أَوْ لَتَعُودُنَّ فِي مُلْتَنَا -

"Ne do të të dëbojmë ty o Shuejb, dhe do t'i dëbojmë besimtarët e tu nga vendi ynë apo ju duhet të ktheheni në religionin tonë. (Al-A'raf:88)

Mirëpo, Hazret Shuejbi iu përgjigj me këto fjalë:

أَوْ لَوْ كُنَّا كَرِهِينَ

*Megjithëse ne nuk dëshirojmë? (Al-A'raf:89)*

Gjithashtu, edhe kombi i Nuhit a.s. e mori këtë vërejtje se do të gurëzohet poqëse nuk do të kthehej në religionin e tij të mëparshëm:

قَالُوا إِنْ لَمْ تَنْهِهِ يُنُوحُ لِكُلِّ أُنَوْنَ مِنَ الْمَرْجُومِينَ -

"Ata mosbesimtarë thanë, nëse nuk do të heqesh dorë O Nuh! Ti me siguri do të jesh një ndër ata që do të gurëzohen". (Al- Shoara: 117)

Sjelljet e këtilla nuk u treguan vetëm ndaj disa profetëve, por u treguan ndaj të gjithëve. Pra, sjelljet e disa mosbesimtarëve Kur'ani i përmend me këto fjalë:

وَقَالَ الَّذِينَ كَفَرُوا إِلَيْهِمْ لَتُخْرِجُنَّكُمْ مِّنْ  
أَرْضِنَا أَوْ لَتُمُورُونَ فِي مَلْيَنا -

"Mosbesimtarët u kanë thënë profetëve të tyre se ne do të ju dëbojmë nga vendi ynë gjerësa të mos ktheheni në religionin tonë. (Ibrahim:14)

Hazrat Ibrahimim a.s. u dënuia për shkak se u largua prej fesë së stërgjyshëve të tij e për shkak se e ngriti zërin e vërtetësisë. Mirëpo, njerëzit dominues e shfaqin hidhërimin e tyre me këto fjalë:

قَالُوا حَرَقُوهُ وَأَنْصُرُوا الْهَمَّامَ كَذَلِكُمْ فَعَلَيْنَ -

Ata thanë: djegeni Ibrahimin në zjarr se në këtë mënyrë mund t'ua jepni ndihmë zotave tuaj, nëse keni ndërmend të bëni diçka. (Al-Anbiya:69)

Në të njëjtën mënyrë, edhe Jesu Krishti u kryqëzua, sepse sipas jahudëve ai nuk pajtohej me atë interpretim të Biblës që u paraqit prej dijetarëve jahudë. Megjithëse, ai pohoi haptazi:

"Mos mendoni se kam ardhur që ta prish dhe ta mohoj Sheriatin dhe profetët. Unë s'kam ardhur t'i mohoj, por kam ardhur që t'i plotësoj. Unë ju them të vërtertën se deri sa do të ekzistojë qielli e toka, nuk do të ndërrohet as një pikë e as një shenjë e Sheriatit të shenjtë, përderisa të mos përsoset i téri". (Mateu 5:17-18)

Këtu duhet t'ju them se diferenca qenësore midis Krishtit e dijetarëve jahud sillej rrëth interpretimit të këtij ajeti të Tevratit,

"Dhe Elijah shkoi nëpër qiell me anë të një vorbulli"

(Mbretër 2:11)

Dijetarët e asaj kohe ia dhanë këtij ajeti domethënien e dukshme letrare. Ata besonin se Elijah do të zgresë me trupin e tij fizik nga qielli para ardhjes së Krishtit. Ndërsa, Krishti fliste me ton të sigurtë se kjo është alegori dhe është e shprehur në mënyrë simbolike. Pra, ai deklaroi se Gjoni-biri i Zakarit është ai Elijah i cili duhej të zbriste prej qiellit. Jesu Krishti e dinte mirë se Gjoni është lindur në tokë dhe nuk është zbritur prej qiellit. Kur e pyetin Krishtin se pse dijetarët thonë se Elijah i parë duhet ardhur? Ai iu përgjigj:

*"Elijah duhet të vijë dhe ai do riprodhojë gjithëçka, por unë ju tregoj se Elijah paska ardhur dhe këta e njohën, por ndaj tij janë sjellë ashtu siç dëshiruan. Pra, edhe biri i njeriut do të trazohet nga duart e tyre. Atëherë, disputj e tij morën vesh se ai ishte duke folur në emër Gjonit Baptist."*

(Mateu 17:10-13)

Në fund dhe mbi të gjitha janë vuajtjet dhe persekutimet që u banë ndaj profetit të shenjtë Muhammedit s.a.s. siç ai vetë deklaron: *"Asnjë profet nuk është persekutuar aq shumë sa unë"*.

Nga e gjithë kjo shihet se historia e feve na mëson se profetët gjithëmonë kanë qenë krijesa njerëzore. Ata kurrrë nuk janë zbritur prej qiellit si heronjtë e disa miteve dhe të përrallave. Ata përherë janë shqetësuar dhe janë trazuar. Ndjekësit e tyre nuk fitojnë lavdërim me anë të mundimeve të dikujt tjetër, por me anë të mundimeve dhe të gjakut të vet.

## RILINDJA E RELIGJIONEVE

Në vitin 1983, Hazrat Mizra Tahir Ahmadi-Imam i Xhematit Islamik Ahmadia, i bëri vizitë Fixhisë. Gjatë qëndrimit të tij në këtë vend, ai mbajti disa ligjérata të rëndësishme. Në faqet e vijuara po japim përkthimin e një ligjërave të tij, të cilën ai e mbajti në Universitetin e këtij vendi.

E përktheu:  
Muhammad Zakaria Khani